



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

19 - 21 Dhjetor 2015



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



ZHURNAL 
Agjenci e Lajmeve

Ramadani për Zhurnal: Nëse ka shkelje të rregullores në ambulancën në Radushë, do të ketë sanksione



Shkup, 18 dhjetor – Duke u bazuar në alarmin që e dhanë banorët e fshatit Radushë në Agjencin e lajmeve Zhurnal, se nuk respektohet orari i punës nga ana e mjekut të vetëm në atë fshat që kryen veprimtari shëndetësore në atë fshat, mjeku Udai.

Sot prononcim për rastin në fjalë dhe Drejtori i Fondit për sigurim shëndetësor, Orhan Ramadan i cili tha pasi e ka pranuar informatën e tillë ai do të urdhëroj që një ekip e fondit të bëjë inspektimin në Ambulancën e Radushës.

"Unë sapo pranova informatën, menjëherë të hënën do të dërgoj një ekip inspektimi në ambulancën e fshatit Radushë, dhe nëse vërtetohet se mjeku në fjalë nuk e respekton kontratën me fondin shëndetësor për angazhim me orarë të plotë, atëherë do të ndërmerren masa adekuate ndaj mjekut dhe i njeiti do të dënohet", ka deklaruar për Zhurnal, Ramadan.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Në "Alo doktor" 1.106 thirrje për një javë



Në linjën telefonike për këshillë mjekësore "Alo doktor" (02/15 123) gjatë javës së kaluar janë regjistruar 1.106 telefonata. Nga hapja e linjës në shtator të këtij viti këshillë mjekësore kanë kërkuar 67.407 persona, njoftoi sot Shtëpia e Shëndetit Shkup.

Linja është e hapur çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim i drejtëpërdrejtë mjekësor në momentin e paraqitjes së simptomave të ndryshme të çregullimit të shëndetit. Për këshillë mjekësore në dispozicion janë 25 mjekë. Thirrjet janë nga qytetarë nga të gjithë qytetet e Maqedonisë. Telefonatat janë për spektër të gjërë të simptomatologjisë më të ndryshme, më së shpeshti për simptoma respiratore, temperaturë e rritur trupore, virozë sezonale, ftohje dhe kollë, karakteristike për këtë periudhë të vitit.

Sipas Shtëpisë së Shëndetit Shkup, të gjithë personave të cilët kanë kërkuar këshillë mjekësore në "Alo doktor" u është dhënë ndihmë shëndetësore me këshillë dhe terapi adekuate simptomatike.

ALSAT

Shkup, qytetarët apelojnë për masa kundër ndotjes së ajrit



Qindra qytetarë protestuan në kryeqytet kundër ndotjes së ajrit. Protesta u mbajt para zyrës së kryetarit të qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, ndërsa qytetarët kërkuan nga ai që

www.fzo.org.mk



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



të ndërmarrë me urgjencë masa si dhe të ndërpresë me prerjen e pemëve në Shkup.

“Ajër të pastër...tani...këtu. Përsëris, ajër të pastër tani dhe këtu”.

OJQ-të, organizatore të protestës kërkuan nga Institucionet që të fillojnë fushatë kundër ndotësve. Qytetarët kërkuan gjithashtu që të analizohen filtrat në gjitha fabrikat në Shkup dhe të ndalohet lëvizja e makinave të cilat nuk kanë standarde të larta ekologjike.

“Nëse ka vullnet mundet qysh sot të kemi ajër të pastër në qytet, të mos e gënjejmë veten. Se a bëhet fjalë për transportin publik, për koordinim të ngrohjes, për kapacitetet industriale që nuk kanë aspak kontroll, apo për stacione matëse të cilat nuk i kemi dhe nuk mund ta detektojmë problemin. Jemi në një fazë të keqe me ajrin e papastër”, u shpreh Merima Kondov, qytetare.

Brenda një viti disa komuna në Shkup me ajër të ndotur ballafaqohen plot 200 ditë. Sipas raportit vjetor të Ministrisë së Ekologjisë, Tetova mbetet qyteti më i ndotur në vend ndërsa Shkupi dhe Kërçova janë në rend të dytë.

“Sipas të dhënave nga raporti vjetor i ministrisë së mjedisit jetësor Tetova përballet me ajër të ndotur afër 300 ditë në vit, kurse Kërçova dhe komuna e Lisiçes me mbi 200 ditë përballen me të njëjtin problem kurse sipas matësve të tjerë, 100 ditshin me ajër të ndotur e kalojnë shumica e komunave ku ka stacione matëse të cilësisë së ajrit”, thonë nga Ministria e Ekologjisë.

Sipas të dhënave të organizatave qytetare, ajri i ndotur është shkaktar i 1400 vdekjeve në vit në Maqedoni.

Tetovarët presin hapin qeverisë, për të ardhmen e Jugohromit



Nënçmim të inteligjencës së popullatës, kështu e kanë cilësuar analistët vendimin e kryetares së komunës së Tetovës Teuta Arifi, për ndërprerjen e procesit mësimor deri në fund të vitit, si pasojë e ndotjes së ajrit. Ish ministri i arsimit, Sulejman Rushiti thotë se vendimi ka për qëllim zhvendosjen e vëmendjes dhe zbutjen e revoltës që ekziston të mesin e popullatës. Ai, por edhe prindërit thonë se vendimi nuk e zgjidh



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



problemin meqë nxënësit nuk mund të rrinë vetëm se brenda kështu që ata por edhe popullata tjetër mbeten të ekspozuar ndaj helmit kancerogjen.

“Unë mendoj se këto janë masa të përkohshme sa për t’u zbutur zemërimi dhe mllefi i qytetarëve njëjtë sikurse ndodhi në protesta. Dolëm protestuam në mbrëmje sërish ndotja arriti kulmet e veta pra është një nënçmim i inteligjencës që iu bëhet qytetarëve në këtë rast. Mendoj se është thjeshtë një masë sa për të de fokusuar vëmendjen dhe sa për të kaluar revolta mllefi jonë dhe sërish të vazhdoj me avazin e vjetër. Unë mendoj se kot hidhet topi andej këndej sepse dihet si është dhe komuna ka kompetenca që t’i mbroj qytetarët e saj nga helmimi dhe këto janë të përcaktuara edhe me ligje edhe me konventa. Qeveria sigurisht që ka përgjegjësinë e saj. Ministri nëse thirret se ia kanë marr kompetencat atëherë le të bëj një akt burrëror dhe le të jap dorëheqje”, tha Sulejman Rushiti, Ish ministër i Arsimit.

“Ndërprerja e mësimin nuk është zgjidhje sepse siç e shihni edhe vet nxënësit janë nëpër rrugë sërish , pra nuk është ndonjë zgjidhje e madhe për Tetovën për këtë tymin, helmin që është në Tetovë. Siç shihet kjo ndodhi vetëm mos të dalin, pra zonja e hekurt, prej frike që pati ndaj nxënësve që morën një hov të madh edhe pse ne baballarët ndejën urtë dhe vazhdojmë të helmohemi por fëmijët morën guxim dhe dolën kundër helmit pra kjo nuk është preventiv ndërprerja e mësimin se fëmijët janë sërish në rrugë”.

“Në këtë aspekt mendoj se nuk ka një efekt të mjaftueshëm në masë sepse në këtë rast dalim të dëmtuar dy herë një me ndotjen e ajrit, dhe e dyta me mos mbajtjen e mësimin me çka nxënësit do mbesin pas me mësimin dhe sërish të njëjtin ajër do e konsumojnë si në shtëpi si në rrugë e kudo qoftë”.

Ndryshe, pas protestave të mijëra banorëve të Tetovës, ministri i ekologjisë, Nurhan Izairi tha se brenda dy-tre ditëve qeveria do të diskutoj për të ardhmen e Jugohromit lidhur me mos përmbushjen e kriterëve të kërkuara ekologjike. Duke marrë parasysh se vendimet në qeveri merren me shumicë votash por edhe prononcimin e Zv/kryeministrit Vlladimir Peshevski i cili tha se Jugohrimi nuk është ndotësi kryesore, mbetet të shihet nëse vendimi i qeverisë të jetë në favor të banorëve të cilët kanë dhënë afat që deri më 25 dhjetor të mbyllet kombinati.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Virozat mund të parandalohen, higjiena dhe ushqimi me vitamina, thelbësore

Ditëve të fundit pacientët më shumë ankohen nga ftohjet me teshtitje dhe kollitje që mund të komplikohen më shumë pas tre ditëve nëse nuk marrin masa të vizitojnë ordinancat...



Mjekët thonë se për parandalimin e ftohjeve apo gripeve sezonale pa përdorur antibiotikë, ndihmojnë ushqimet me më tepër vitamina si pemët dhe perimet sezonale. Edhe higjiena është shumë e rëndësishme për të shpëtuar nga virozat.

"Paraqiten simptomet e virusit ata mund të jenë me një rinit me ndezje të veshit lotim të syve me organet respiratore me kollitje mund të paraqiten këto viruse dhe u kalon pa antibiotikë me supa të ngrohta çajna të ngrohtë pemë perime sezonale të konsumojnë si dhe

limonada ata shume ndihmojnë dimrit", shprehet mjekja Sefiana Bellcishta.

Personat me sëmundje kardiovaskulare, ata me diabet, si dhe me disa sëmundje të tjera duhet të vaksinohen që të parandalojnë ose lehtësojnë gripet e mundshme sezonale.

"Vakcina u preferojmë atyre personave që janë me rizik faktorë si ato me kardiovaskularë me diabet me organet respiratore me asëm që janë pacientët. U preferohet atyre vakcina cdo vit të marrin në kohën e duhur kur nuk janë të sëmurë nga ftohja gripi apo ndonjë bakterie... kemi fëmijë me anomali të zemrës veshkave me organet respiratore dhe te ata përdoren vakcinat si dhe te gratë shtatzëna përndryshe njeriu i shëndoshë jo sepse simptomet kalojnë për 7 ditë", shprehet mjekja Sefiana Bellcishta.

Duhet të kemi gjithashtu kujdes edhe në ndërrimin e ambientit nga ai i ngrohtë në ambient të ftohtë pasi që në atë mënyrë menjëherë mund të vijë deri te ftohja e mundshme. Gjithsesi me pak më shumë kujdes dhe me ushqimet edukura, virozat e sezonit mund të kalohen edhe pa ilace.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Debat për përdorim të kanabisit për qëllime mjekësore



Debati i dytë publik me temë "Zbatimi i kërpit indian dhe kanabinoideve në qëllime mjekësore" do të mbahet sot në organizim të Agjencisë...

Debati i dytë publik me temë "Zbatimi i kërpit indian dhe kanabinoideve në qëllime mjekësore" do të mbahet sot në organizim të Agjencisë për ilaçe dhe mjete mjekësore në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

Pjesëmarrësit në debat duhet të diskutojnë për Propozim-ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për kontroll të drogave dhe substancave psikotropiakel në drejtim të

përdorimit legal dhe kontrolluar të prodhimeve nga kanabisi për qëllime mjekësore në Maqedoni.

Sipas Propozim-ligjit, kanabisi do të mund të prodhohet dhe përdoret vetëm në Maqedoni. Do të mund ta prodhojnë vetëm perosna juridik./mia

Mjekët rekomandojnë, ndotja e ajrit dëmton syrin



Kruajtja, skuqja dhe lotimi i syrit janë ndër simptomat më të shpeshta që iu paraqiten qytetarëve gjatë stinës së dimrit...

Kruajtja, skuqja dhe lotimi i syrit janë ndër simptomat më të shpeshta që iu paraqiten qytetarëve gjatë stinës së dimrit, e sidomos gjatë pranisë së madhe të mjegullës dhe smogut në ambient.

Në Klinikën Oftamologjike në Shkup edhe nëpër ordinancat e syve në përgjithësi, shumë pak qytetarë kërkojnë ndihmë mjekësore për gjendjen në fjalë.

Mjekët thonë se ambienti i ndotur ndikon negativisht dhe mund të nxit shumë sëmundje dhe infektive në sy.

Autoritet shëndetësore thonë se tani për tani nuk është regjistruar rritje e numrit të pacientëve.

Mjekët thonë se shumica nga ne fare pak janë të njoftuar për paraqitje të alergjisë në sy si pasojë e ajrit të ndotur dhe mjegullës, madje ka të tillë që vendosin këtë gjendje ta kalojnë pa marrë ilaçe.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



“Smogu apo ndotësit e shumtë të ajrit, të cilët përmenden kohëve të fundit në opinion, ndikojnë negativisht edhe në të pamurit edhe në organin e syrit. Mikrogrimcat e shumta shpeshherë mund të shkaktojnë edhe pengesa mekanike në sy dhe gjithashtu prezenca e këtyre grimcave mund të shkaktojë konjuktivitete të shumta alergjike, ku mund të paraqiten në formë pak si më të rënda”,shprehet drejtori i klinikës oftamologjike në Shkup, Iljaz Ismaili.

Autoritet shëndetësore u rekomandojnë qytetarëve që të bëjnë kujdes për pastërtinë e syve, duke i fshirë ata gjithmonë me ujë të pastër atëherë kur do t’u paraqiten disa nga llojet e simptomave të përmendura. Mjekët këshillojnë që për mbrojtje sa më të mirë nga infektimet në fjalë, është e mirë të shmangen daljet e panevojshme në ajër të ndotur.

“Të ruajnë pastërtinë dhe higjienën e syve dhe të mos i prekin sytë me duar të papastra, për shkak se reagimi i parë i pacientit në qoftë se ndjen diçka se ka ndonjë kruajtje është mirë që të mos preken sytë pa u bërë paraprakisht larja e duarve. Sigurisht që uji i pastër është pastruesi kryesor. Qytetarët t’i përmbahen këshillave që së paku kur është niveli i lartë i ndotjes së ajrit të mos dalin jashtë”,shprehet drejtori i klinikës oftamologjike në Shkup, Iljaz Ismaili.

Në rast se këto simptoma vazhdojnë për tre ditë me radhë, është e këshillueshme që qytetarët të paraqiten tek mjeku për të marrë ndihmë mjekësore.

PORTALB
dritare realiteti

Strugë, përfaqësimi i shqiptarëve në spital është simbolik



Nga 18 persona, të cilët ditë më parë morën vendime për punë në Spitalin e qytetit të Strugës, vetëm se katër janë shqiptar.

Bëhet fjalë për vullnetarë të cilët me vite të tëra kanë punuar si në këtë spital. Numri i përgjithshëm i atyre që do të zgjidhin statusin e punës gjatë periudhës së ardhshme, është 56, prej tyre vetëm 18 janë shqiptarë. Drejtori Mentor Ibrahim thotë se numri i shqiptarëve të pranuar në punë

është simbolik dhe për këtë kanë reaguar edhe pranë Ministrisë e Shëndetësisë e cila edhe ka bërë përzgjedhjen, transmeton Alsat M.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Ditën e hënë, Todorov para interpelancës, sektori civil kërkon dorëheqjen e tij



Ditën e hënë me fillim në ora 18:00, para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë do të mbahet protestë qytetare, që të votohet mosbesim ndaj ministrit të shëndetësisë Nikolla Todorov. Nga platforma qytetare "Hajde" thonë se deputetët e Republikës së Maqedonisë duhet ta vënë veten si pacient dhe atëherë interpelanca kundër Todorovit do të votohet.

Ata thonë se sistemi i shëndetësisë dhe shëndeti i qytetarëve nuk duhet të përdoren për qëllime politike dhe se ministri Todorov duhet nevojat e qytetarëve ti vëndon në vend të parë e jo të ju jep prioritet politikave të tyre partiake të cilat i udhëheqin.